

VENDIM
Nr. 131, datë 2.7.2024

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS, PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“ACHELO” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 2.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1534/1 prot., datë 27.6.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘ACHELO’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “ACHELO” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1534 prot., datë 20.6.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Kotorri”, me kapacitet prodhues 1.9 mw, me vendndodhje në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

- Shoqëria ka kryer, për llogari të ERE-s, pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “ACHELO” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin/informacione në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “b” dhe “c”; për pikën 2, gjerat: “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2, dokumentacioni juridik dhe administrativ:

- germa “b”: të depozitohen vërtetimet e gjendjes gjyqësore për administratorin dhe shoqërinë me afate të rifreskuara sipas rregullores së licencimit (neni 8, pika 3).

Pika 1.3, dokumentacioni financiar dhe fiskal:

- germa “a”: të depozitohet vërtetimi nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Elbasan që nuk ka detyrime të papaguara, lidhur me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Shoqëria ka depozituar në ERE VNM-në paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. AN160820220002, datë 14.9.2022, Komisioni 61, me afat vlefshmërie deri më datë 14.9.2024. Si e tillë, shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion nëse ka filluar punimet.

- Në kuptim të këtij neni (neni 9, pika 1.3, germa “b” dhe “c”), shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion në zbatim të rregullores së licencimit për mbështetjen financiare, por duhet të sqarohet nga ana e saj mënyra e kthimit të huas së marrë nga ortakët e vetë shoqërisë, pasi nuk është specifikuar

mënyra e kthimit të kësaj shume. Gjithashtu, duhet të saktësohet nga ana e shoqërisë nëse plani i biznesit do të pësojë ndryshime në lidhje e në kuptim të mënyrës së financimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ACHELO” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Kotorri”, me kapacitet prodhues 1.9 mw, me vendndodhje në pjesën fundore të përroit të Seltës, degë e lumit të Holtës, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, qarku Elbasan.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti